



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 132
Prishtinë, më 14 tetor 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 14 TETOR 2010**

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi, kurse i ndihmuan **Xhavit HALITI** dhe **Ibrahim GASHI**, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime të deputetëve,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi P procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 7 tetor 2010,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, dhe
7. Shqyrtimi i Rekomandimit për Propozim-Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës.

1. Koha për deklarime të deputetëve

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Myrvete Pantina, Nait Hasani, Xhevdet Neziraj, Gani Geci, Rita Hajzeraj-Beqaj, Rexhep Hoti, Gjylnaze Syla, Ramadan Avdiu, Besa Gaxherri, Hafize Hajdini dhe Jakup Krasniqi, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Ismajl Kurteshi**, parashtoi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi lidhur me bisedimet teknike në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në të ardhmen.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj kësaj pyetjeje të deputetit Kurteshi.

Deputeti **Driton Tali**, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi apo ministrin Ahmet Shala lidhur me ndaljen e kontrabandës me derivate në Mitrovicë.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Naim Rrustemi**, parashtoi pyetje për ministrin Bujar Bukoshi lidhur me vlerësimet paraprake të Ministrisë së Shëndetësisë rreth dëmtimit të buxhetit të Kosovës me blerjen e barnave.

Ministri **Bukoshi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputetja **Gjylnaze Syla**, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me realizimin e të drejtës në pronësinë e banesës të familjes mërgimtare, Pireva, e cila jeton në Zelandën e Re.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi apo për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi lidhur me hapat që duhet të ndërmarrë Qeveria për regjistrimin e plotë dhe të saktë të numrit të automjeteve në bazën e të dhënave të Ministrisë së Administratës Publike.

Zv.kryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për ministrin Lutfi Zharku lidhur me inspektimin dhe monitorimin legal të qarkullimeve dhe përdorimeve të metaleve të çmuara në vendin tonë.

Ministrin **Lutfi Zharku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Driton Tali**, parashtoi pyetje për ministrin Bujar Bukoshi lidhur me emrat e personave publikë të institucioneve të Kosovës të cilët tjetërsuan pronën e QKUK-së.

Ministri **Bukoshi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Gjylnaze Syla**, parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq lidhur me hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 7 tetor 2010

Procesverbali i mbledhjes plenare, të mbajtur më 7 tetor 2010, u miratua pa vërejtje, ndërsa deputetit Riza Smaka pati vërejtje në Transkript që në vend të fjalës “zoti” para emrit të tij të përdoret fjala “zotëri”.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Ministri **Ahmet Shala**, tha se ministria që ai drejton, në kuadër të strategjisë legislative për vitin 2010 ka hartuar Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, të cilin po e shqyrtojmë sot.

Ky Projektligj është punuar nga ekspertë vendorë dhe ata ndërkombëtarë dhe ka marrë parasysh praktikat më të mira të vendeve të rajonit dhe të shteteve të BE-së nga kjo fushë, tha ai. Deri më tani kjo fushë ka qenë e rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut nr. 2001/30.

Në vazhdim, tha se Projektligji rregullon sistemin e kontabilitetit dhe raportimin financiar të shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrat e Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, licencimin e auditorëve dhe firmave vendore dhe të huaja të auditimit, ndalimin e keqpërdorimit të informatave, procedurat e auditimit etj.

Më tej, ai vuri në pah se Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, pas miratimit do të ndikoj sado kudo në fuqizimin e shtetit të Kosovës në fushën e biznesit. Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Driton Tali, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe ministri Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integrime Evropiane dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për patenta.

Ministri **Lufti Zharku** tha se ministria që ai drejton, në kuadër të Strategjisë legislative për vitin 2010 ka hartuar Projektligjin për patenta, të cilin po e shqyrtojmë sot.

Në vazhdim, tha se ky projektligj bashkë me Projektligjin për dizajnin industrial, i cili kohë më parë është miratuar në parim në Kuvend, përbëjnë kompletimin e legjislacionit nga kjo fushë.

Projektligji për patenta rregullon kushtet për mbrojtjen e shpikjeve me anë të patentës, fitimin dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes, procedurat e regjistrimit, përfundimin e vlefshmërisë dhe të anulimit të patentës, tha ai.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit për patenta nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për patenta.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputeti, Riza Smaka, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----72,
Kundër-----1,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për patenta.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri – komision raportues- e arsyetoi anëtari i këtij komisioni, Shkumbin Demaliaj.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Demaliaj, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----81,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.

7. Shqyrtimi i Rekomandimit për Propozim-Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion e ka shqyrtuar Vendimin e Kuvendit nr. 03-V-393, të datës 27 korrik 2010 për Propozim – Vendimin e Qeverisë për Privatizimin e PTK-së, nr. 01/130 të datës 16 qershor 2010 dhe sqarimet shtesë të Qeverisë nr. 1372, të datës 2 shtator 2010, dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për plotësimin e Strategjisë së Qeverisë për Privatizimin e PTK-së, për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare. Ai ftoi kryeministrin e Kosovës që të paraqesë arsyetimin për strategjinë.

Kryeministri **Hashim Thaçi**, tha se pas miratimit në parim të Strategjisë për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës në këtë Kuvend, para disa javësh, Qeveria e Republikës së Kosovës ka adresuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e Kuvendit në lidhje me privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës.

Në vazhdim, tha se ne, duke e zhvilluar vendin sipas modeleve të botës perëndimore, do të pranojmë ekonominë konkurrense dhe të tregut të lirë.

Privatizimi i Postë -Telekomit të Kosovës është reformë ekonomike, e cila është në pajtim edhe me rekomandimet e FMN-së, e cila do t'i mundësojë vendit rritje të mëtejme ekonomike, gjithnjë duke e pasur mbështetjen e plotë edhe të partnerëve tanë ekonomikë, si në Uashington dhe në Bruksel. Një opinion në favor të privatizimit të Postë -Telekomit të Kosovës e kanë paraqitur edhe Oda Ekonomike Kosovës dhe ekspertë tjerë kosovarë, tha ai.

Më tutje, theksoi se Strategjia për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës nuk është listë dëshirash, por reformë e thellë ekonomike, e cila do t'i ndihmojë vendit në rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës në tërësi, dhe si e tillë nuk është vetëm e një grupi apo subjekti politik, por e të gjithë neve.

PTK do të vazhdojë të jetë kompani e Kosovës dhe do të ofrojë shërbime për qytetarët e saj, duke garantuar se asnjë punëtor i saj nuk do të humb punën si pasojë e privatizimit të PTK-së në periudhën katër vjeçare, konstatoi kryeministri Thaçi.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të udhëheq një proces shumë transparent në privatizimin e ndërmarrjeve publike të vendit dhe si rezultat i kësaj disa kompani më të fuqishme nga fusha e telekomunikacionit kanë paraqitur kërkesën për t'u parakualifikuar për privatizimin e PTK-së, theksoi ai.

Në përmbyllje të fjalës së tij, ai u fokusua në vonesat kohore dhe pasojat që mund të ketë vendi nga mosmiratimi eventual i strategjisë së privatizimit, siç janë investimet e mundshme nga institucionet dhe donatorët e ndryshëm. Në fund, ai ftoi deputetët për miratimin e Strategjisë së privatizimit të Postë -Telekomit të Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një kohë të pacaktuar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë strategji dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulëzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Branislav Gërbiç, si dhe kryeministri Hashim Thaçi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim mocionin përmbajtësor të Grupit Parlamentar të LDK-së, për shtyrjen e shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----53,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi mocionin përmbajtësor të Grupit Parlamentar të LDK-së për shtyrjen e shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin e Rekomandimit për Propozim-Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----47,
Kundër-----2,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale